

VENDIM
Nr. 243, datë 2.12.2021

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

(Ndryshuar me vendim ERE nr. 235, datë 19.7.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 2.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 145/1 prot., datë 25.11.2021, nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Noa Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 220, datë 27.10.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- ERE, me shkresën nr. 6/16 prot., datë 28.10.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët, nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Shoqëria, me shkresat nr. 1001/2 prot., datë 19.11.2021 dhe nr. 1001/3 prot., datë 22.11.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar në zbatim të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gjerat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, gjerat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, plotësuar;

- dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “g” dhe “h”, plotësuar.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.7:

- germa “e” (sistemin e IT-së së krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi), plotësuar pjesërisht. Duke qenë se shoqëria është në proces për krijimin e sistemit IT, vlerësojmë që t’i lihet si kusht depozitimi në ERE i sistemit IT, me fillimin e operimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Noa Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti